



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:145029

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766125

P.nr.4/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Valon Hajdini, me bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.B. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentave nga neni 398 par.1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.23/2018 të datës 29.03.2024, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësorë, me datë 31.05.2024, nxjerrë këtë :

A K T V E N D I M

HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.23/2018 e datës 29.03.2024 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit:

A.B. nga babai Xh. dhe nëna H., e vajzërisë D., i lindur me datë... në fshatin..., Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, i martuar – baba i një (1) fëmije, i gjendjes se dobët ekonomike, për veprën penale: Falsifikimi i dokumentave nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

-Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

-Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore-juridike, gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

- A r s y e t i m -

Prokuroria Themelore në Rozhajë – Mali i Zi, ka paraqitur propozim akuzë me nr.KT.Nr. 167/17 të datës 20.11.2017 kundër të pandehurit A.B. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentave nga neni 412 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Malit të Zi, ndërsa Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.23/2024 të datës 29.03.2024, kundër të pandehurit A.B. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentave nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj me Aktvendimin P.nr.4/2018 të datës 19.04.2023, ka hedhë e Prokurorisë Themelore të Malit të Zi – Rozhajë PP.II.nr.167/2017 të datës 20.11.2017, ndaj të pandehurit A.B., për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumentave nga neni 412 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Malit të Zi, për shkak të mos Plotësimit të Lëndës PP.II.nr.167/2017 të datës 20.11.2017 nga ana e Prokurorit të Shtetit sipas kërkesës se gjykatës për Plotësimin e Lëndës PP.II.nr.167/2017 të datës 20.11.2017.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin PN.nr.562/2023 të datës 05.06.2023, duke vendosur sipas ankesës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe sipas detyrës zyrtare, ka aprovuar të njëjtën dhe ka anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.4/2018 të datës 19.04.2023, duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje me arsyet dhe shkaqet e përcaktuara si në këtë aktvendim, me theks të veçantë se Prokurorisë se shtetit duhet t'i ipet afat shtesë për plotësimin e kësaj lëndë.

Gjykata duke iu referuar Aktvendimit të Gjykatës se Apelit të Kosovës PN.nr.562/2023 të datës 05.06.2023, ka vepruar sipas këtij aktvendimi, ashtu që i ka dhënë afat shtesë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për plotësimin e lëndës, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij njoftimi, duke e obliguar Prokurorinë Themelore në Mitrovicë që brenda këtij afati shtesë të plotësoj Lëndën PP.II.nr.23/2018 të datës 24.01.2018 (Aktakuza e Prokurorisë Themelore e Malit të Zi-Rozhajë PP.II.nr.167/2017 e datës 20.11.2017).

Gjykata ka pranuar njoftimin nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në të cilën është theksuar se vepra penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 412 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Malit të Zi, duhet të zëvendësohet dhe të përshtatet me vepër penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket dokumentacionit origjinal ka theksuar se do të ia bashkëngjisë kësaj shkresë të gjitha shkresat që gjenden në lëndë

(përfshirë edhe dokumentacionin me nr.158-7841025-01) e po ashtu Aktakuzën e cila është e përkthyer nga gjuha malazeze në gjuhen shqipe por që deri me tani ende nuk i janë sjellë të përkthyer në gjuhen shqipe, e as aktakuza nuk është plotësuar (përpiluar sipas legjislacionit të dispozitave të KPK-së), ashtu që Gjykata që i ka dhënë edhe një afat shtesë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për plotësimin e lëndës, në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e pranimit të këtij njoftimi, duke e obliguar Prokurorin Themelore në Mitrovicë që brenda këtij afati shtesë të plotësoj Lëndën PP.II.nr.23/2018 të datës 24.01.2018 (Aktakuza e Prokurorisë Themelore e Malit të Zi-Rozhajë PP.II.nr.167/2017 e datës 20.11.2017), si në kërkesat e kësaj gjykate.

Ndërlidhur me këtë Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 29.03.2024, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.23/2024 të datës 29.03.2024, kundër të pandehurit A.B. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Me këtë lëndë penale jam ngarkuar më datë 19.01.2024, e njëjta i është kthyer në plotësim më datë 13.03.2024 në mënyrë që aktakuza të përshtatet me legjislacionin e vendit tonë pasi që nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë ishte dorëzuar aktakuza sipas legjislacionit të shtetit të Malit të Zi, më datë 02.04.2024 Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj aktakuzën e hartuar sipas legjislacionit të shtetit lidhur me veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë vështrimit në shkresat e lëndës sipas detyrës zyrtare gjeti se, tani ndaj të pandehurit A.B., për veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së.

Në nenin 106 par. 1 nënpar. 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tri (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vjet burgim. Ndërsa, sipas nenit 107 par.8 të KPRK-së, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Në rastin konkret për veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

I pandehuri dyshohet se veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, e ka në vitin 2017, çka do të thotë se kanë kaluar me shumë se gjashtë (6) vjet nga koha kur dyshohet se i pandehuri e ka kryer këtë veprë penale, pra ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit dhe në këtë mënyrë me 31.12.2023 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 107 par. 8 të KPRK-së.

Gjykata, pasi ka vërtetuar së në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, vlerëson se parashkrimi është një rrethanë e cila pengon ndjekjen e mëtejme penale, andaj në bazë të këtyre arsyeve vendosi që të hedhë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.23/2018 të datës 29.03.2024, dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit A.B., për veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Meqenëse në këtë çështje penale palë të dëmtuar nuk kishte, gjykata për kërkesën pasurore-juridike, nuk vendosi fare në procedurë penale.

Gjykata Aktvendimin mbi parashkrimin absolut e mori në kuptim të nenit 106 par.1 nënpar.1.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së, lidhur me nenin 357 par. 1, nënpar. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm -

P.nr.4/2018 me datë 31.05.2024.

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda afatit prej 3 (tre) ditëve, nga dita e pranimit përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.